



Primit / Dohetuar Prilipen / Pristaba Received / Doavety	25-09-2023	3	viti god Year
Organ / Shërbimi Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr. Prot. Pr. Prot. Prot. No	Shtesa Prilog Appendix	Shtesa Priloga Appendix
SKM/SHCK	3810/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.499/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në lidhje me ankesën A.nr.499/2023 të datës 15.03.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Ismail Ismaili", Nr.1,në Gjilan, kundër Vendimit me Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.499/2022 të datës 15.03.2023 të parashtruar nga ankuesi .

A r s y e t i m

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me Vendimin me Nr.Ref.BD-173/3 të datës 30.11.2022 ka aprovuar Rregulloren Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me datën 14.12.2022 ka nxjerr Vendim DM 1118/2022, përmes të cilit ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për shqyrtimin e mundësisë së sistemit të çdo nëpunësi civil si pasojë e miratimit të Rregullosës Nr.07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Burimet Njerëzore me datën 13.02.2023 ka njoftuar disa prej nëpunësve civil të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mesin e tyre dhe ankuesin se Komisioni i Ristrukturimit në propozimin e tij do të mbështetet në kriteret specifike të vendeve të lira apo të atyre të krijuara, kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve.



Drejtori i Burimeve Njerëzore me datën 23.12.2022 ka njoftuar ankuesin që me Rregulloren Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pozita e Departamentit të Likuidimit është shuar, duke e njoftuar të njëjtin që Komisioni i Ristrukturimit konform dispozitave ligjore në fuqi do të trajtojë mundësinë e sistemimit në një pozitë të lirë ekzistuese.

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me Vendimin me Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 ka udhëzuar Drejtorin Menaxhues të shpall konkurs publik për pozitën *Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve*, ndërsa me datën 15.03.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr.Reference: RN0011161 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën *Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve*.

Nëpunësi civil [ ] cili në bazë të Akt Emërimit të datës 29.12.2022 ka mbajtur pozitën *Drejtor i Departamentit të Likuidimit*, me datën 15.03.2023 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 2672/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 28.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa Këshilli me datën 05.04.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për **Përfundim të procedimit administrativ** të filluar me ankesën me numër A.nr.499/2022 të datës 15.03.2023 e parashtruar nga ankuesi

, sepse:

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës, Kolegji i këshillit konstaton se ankuesi me datë 15.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2672/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me objekt kontesti anulimin e të njëjtit dhe duke kërkuar që komisioni i ristrukturimit të vazhdoj me sistematizimin e zyrtarëve që i plotësojnë kriteret ligjore në pozitë të *Drejtorit të Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka konstatuar se ndërlidhur me ankesën A.nr.451/2023 të datës 03.03.2023 e parashtruar nga ankuesi z. R.Z, më datë 18.04.2023 Këshilli ka nxjerrë vendimin A.nr.451/2023 për objektin e njëjtë të ankesës me të cilin vendim ka aprovuar ankesën e z.R.Z duke e anuluar Vendimin me Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Konkursin me Nr.Reference RN00011161 të datës 15.03.2023 për pozitën *Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes*, duke obliguar institucionin që të ndërmarr veprimet juridike me qëllim që të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht neni 54 dhe dispozitat e Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë dhe në këtë kuptim me qenë se tashmë është anuluar vendimi Nr.Ref.BD-176/2 i datës 14.02.2023 i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit që ka qenë objekt i këtij kontesti si dhe Konkursi me Nr.Reference RN00011161 i datës 15.03.2023 për pozitën *Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes* duke



obliguar institucionin që të ndërmerr veprimet si më lartë të potencuar në këtë arsyetim të këtij vendimi, janë krijuar kushtet ligjore për përfundim të procedimit administrativë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës dhe nga ajo që u konstatue më lartë gjithnjë bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot"*, andaj duke konstatuar faktin se Këshilli ka vendosur për objektin e njëjtë të kësaj ankese përmes vendimit A.nr.451/2023 të datës 18.04.2023, vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën me numër A.nr.499/2023 të datës 15.03.2023 të parashtruar nga ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

#### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.499/2023, datë 25/04/2023.

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



#### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së